

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 525 Prot.

Tiranë, më 28.07 2015

VENDIM Nr. 81 datë 15.07.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, të datës 15.07.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kisha Paleokristiane në Sukën e Gjelit, Lezhë"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Gëzim Hoxha,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kisha Paleokristiane në Sukën e Gjelit, Lezhë"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Gëzim Hoxha në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Vazhdimi i gërmimit me qëllim:
 - Sqarimin e planimetrisë së apsidës dhe sanktuarit;
 - Sqarimin e dyshemesë së Kishës;
 - Sqarimin e statigrafisë së kishës në pjesën lindore të saj.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO